



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Zyra e Kryetarit

01Nr: *16-5821/15*

Kaçanik, *20.02.2015*

RAPORTI I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2014

K a ç a n i k, Shkurt 2015

Vështrim hyrës

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin Vjetor të punës i cili përmban punën dhe aktivitetet njëvjeçare, të arriturat e Komunës dhe njëkohësisht vështirësitë me të cilat jemi përball gjatë vitit 2014. Jam munduar të zbatojë aktivitetet që janë të përcaktuara me Statut të Komunës dhe zbatimin e përgjegjësi si kryetar i Komunës duke administruar pushtetin lokal në harmoni me kompetencat e kryetarit. Duke qenë përfaqësues i Komunës dhe duke vepruar në emër të saj, jam munduar të shtrijë bashkëpunimin e Komunës me qytetarët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme, rininë etj. Një bashkëpunim të sinqertë e kam zhvilluar edhe me partitë politike e veçanërisht me opozitën duke krijuar një klimë bashkëpunuese, gjithnjë në interes të gjithë qytetarëve. Takimet dhe debatet me qytetarët kanë qenë të shpeshta, ndërsa janë trajtuar tema të ndryshme me theks të veçantë Buxheti i Komunës për vitin 2015. Unë jam i kënaqur që kemi arritur të vazhdojmë me investime në infrastrukturën rrugore, rrjete kanalizimesh e ujësjellës. Janë asfaltuar afër 30 kilometra rrugë të reja, afër 11 kilometra rrjete kanalizimesh dhe investime në ujësjellës. Ndër projektet më madhore të realizuara gjatë vitit 2014 do të veçoja asfaltimin e rrugës Gajre-Ivajë-Shtrazë, rrugës së Dubravës e Rekës, fillimin e punëve për ndërtimin e objektit të palestrës sportive ndërkohë që janë bërë punët përgatitore për nisjen e objektit të QKMF-së, objekt me rëndësi të veçantë për gjithë qytetarët. Edhe këtë vit kanë vazhduar investimet në fushën e trashëgimisë kulturore, si një thesar shumë i çmuar i Komunës sonë, pas hartimit të Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore, një dokument shumë i rëndësishëm. Natyrisht që mbetet edhe shumë për të bërë. Ndërkohë, duke e konsideruar arsimin si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të gjithmbarshëm shoqëror, janë bërë investime me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe arritjen e standardeve më të avancuara. Komuna e Kaçanikut e ka shpenzuar 97,21 % të buxhetit të alokuar për vitin 2014. Nga gjithsej 188,065 euro mjete të paspenzuara, 35,625.21 euro janë kthyer në Buxhetin e Kosovës, ndërsa 152,440.19 euro do të barten në buxhetin e vitit 2015. Buxheti final i 2014-së ka qenë në shumë prej 6,915,787 euro, prej të cilave 6,159,298 euro ose 89.06% nga granti qeveritar dhe 756,489 euro ose 10,94 % nga të hyrat vetjake komunale, ndërsa është shpenzuar 94.65 % ose në shumë prej 6,545,962 euro. Gjatë vitit 2014 ishin planifikuar të shpenzohen 1,698,515 euro për investime kapitale, ndërsa janë realizuar 1,454,299 euro ose 85.62 % . Në vitin 2014 ishte planifikuar që të grumbullohen gjithsej 630 mijë euro nga të hyrat vetjake komuna ndërsa janë realizuar 533,685 euro ose 84.71% .

Prioritetet kryesore për Kaçanikun vazhdojnë të jenë:

- Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqenies së qytetarëve.
- Krijimi i kushteve të volitshme për investime të drejtpërdrejta, shtimi i vendeve të Të reja të punës të punës dhe zhvillimit ekonomik.
- Procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje
- Hartimi i hartave zonale
- Ushtrimi me përgjegjësi i kompetencave në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës, administratën e saj dhe zbatimin e akteve të Kuvendit të Komunës.

- Mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës dhe zbatimin e planeve investuese të komunës, përkatësisht investimet substanciale në infrastrukturë duke përfshirë rrugët, ujin e pijshëm dhe kanalizimet.

- Bashkëpunim ndërkomunal, nivelet qendrore, Asociacionin e Komunave të Kosovës Organizatat ndërkombëtare etj.

Komuna e Kaçanikut prioritetet Strategjike gjatë vitit 2014 kishte:

- Ofrimi i shërbimeve të shpejta e cilësore
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike për krijimin e kushteve për investime në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e turizmit etj.
- Procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike, me theks të veçantë në rrugë, rrjete ujësjellësish dhe kanalizime.
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmes ngritjes së kapaciteteve teknike dhe njerëzore.
- Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe ngritja e cilësisë
- Promovimi i trashëgimisë kulturore
- Përmirësimi i aktiviteteve rinore

Shërbimet janë ofruar përmes drejtorive dhe zyrave si në vijim:

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike dhe
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

Çfarë kemi arritur

Tabela në vijim përmbledhë aktivitetet dhe arritjet kryesore gjatë vitit 2014. Më shumë hollësi janë dhënë në Shtojcën e bashkëngjitur në këtë raport, në të cilën jepen informata lidhur me performancën e secilës drejtori/program.

Prioriteti 1: Ofrimi i shërbimeve të shpejta e cilësore									
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti					Arritjet/progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2014				
- Kryerja e të gjitha shërbimeve për qytetarë në një vend që ka mundur shërbime të shpejta e cilësore					Janë realizuar 99,80 % e kërkesave, përkatësisht janë protokoluar dhe lëshuar 39,329 dokumente				
Nr.	Departamenti	Në pritje për pranim	Të pasqyruara	Në proces	Miratuara	Refuzuar	Hedhur poshtë	Pezulluar	Totali
1	01. Shërbimi i Kryetarit	0	25	137	1161	137	1	1	1462
2	02. DAP	0	0	4	24197	17	149	1	24368
3	03. DSHMS	0	3	1	193	12	6	1	216
4	04. DAK	0	6	0	437	382	29	0	854
5	05. DEFZH	0	0	8	5491	18	15	1	5533
6	06. DUKMM	0	0	520	5098	46	82	3	5749
7	07. DESHP	0	42	29	214	32	0	9	326
8	08. DBZHP	0	0	3	805	12	1	0	821
9	Gjithsejt	0	76	702	37596	656	283	16	39329

Prioriteti 2: Procesi i trajtimeve të ndërtimeve pa leje	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2014

Aplikimi dhe futja në sistem e të dhënave për ndërtimet pa leje	Janë identifikuar afër 1200 objekte pa leje dhe janë futur në sistem të dhënave për afër 650 objekte
---	--

Prioriteti 3: Ofrimi i shërbime publike dhe krijimi i infrastrukturës	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014
Përmirësimi i infrastrukturës rurale	Janë asfaltuar afër 30 km rrugë, 11 km kanalizime, afër 5000 m ² rrugica me kubëza betoni dhe investime në mirëmbajtjet dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit.
Mirëmbajtja e ndriçimit publik	Rrugët e qytetit në vazhdimësi kanë qenë të ndriçuara nga ndriçimi publik.

Prioriteti 4: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014
Asfaltimi i rrugëve lokale	Është arritur të asfaltohen dhe të shtrohen me kubëza betoni rreth 5000 m ² rrugica Është përmirësuar maksimalisht qarkullimi i njerëzve dhe automjeteve.

Prioriteti 5: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përmes përmbushjes së nevojave për ngritje të kapaciteteve teknike dhe njerëzore	
Mbulimi me mjekë i QKMF-së dhe AMF-ve	Në QKMF është bërë mbulimi me mjekë, ndërsa pacientëve iu është mundësuar shërbime më të afërta në qendër përderisa për këto lloje shërbimesh kanë qenë të detyruar të vizitojnë qendra tjera.
Përmirësimi i kushteve të punës	Janë bërë punët përgatitore për fillimin e ndërtimit të objektit të QKMF-së në Kaçanik. Objekti do të ndërtohet në bashkëfinancim të Komunës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Caritasit të Luksemburgut.

Aplikimi i mjekësisë familjare në QKMF, QMF dhe AMF	- Ka vazhduar implementimi i mjekësisë familjare sipas standardeve në të gjitha qendrat mjekësore familjare
---	---

Shërbimet shëndetësore të kryera gjatë vitit 2014

1. Në sektorin e mjekësisë Familjare	34.894
2. Sektori i Emergjencës	30.299
3. Sektori i Stomatologjisë	8.179
4. EKG.....	2.120
5. Sektori i Lindjes	3
6. Sektori i Pulmologjisë	563
7. Shëndeti Mental	275
8. Në këshillimoren e grave	1.434
9. Në shërbimin e vaksinimit	9.606
10. Sektori Laboratorik	8.251
11. Sektori i rëntgenit.....	3.353

Shërbimet e infermerisë në QKMF, QMF dhe AMF, 139.686

Totali i shërbimeve në QKMF, 238.695 shërbime

Prioriteti 6: Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe ngritja e cilësisë	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014	
Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i njohurive të nxënësve	Është mbajtur testi i maturës dhe rreth 90 % të maturantëve kanë kaluar testin. Rezultatet e Testit të arritshmërisë për klasat IX, kanë treguar performancë relativisht të mirë me tendencë rritjeje në krahasim me vitin paraprak
Organizimi i trajnimeve profesionale për mësuesit e klasëve të para	Mësuesit kanë fituar njohuri dhe përvoja në metodologjinë e mësimit të Abetares unike,
Zhvillimi i aktiviteteve	Organizimi i garave të diturisë:

jashtëmësimore	<p>Olimpiada e matematikës së Kosovës; Gjuhëtari i Ri 2014; garat në nivel komunal në 7 lëndë mësimore, Universiada 2014, garat e kimisë dhe gjuhës angleze në kolegjin "Mehmet Akif" etj.</p> <p>Në të gjitha garat, nxënësit kanë arritur rezultate mbresëlënëse</p>
Investimet në objektet shkollore	<p>Investime në objektin e SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka", respektivisht realizimi i projektit për efikasitet.</p> <p>Në shkollën fillore "Kadri Zeka" është bërë ndërimi i dritareve</p> <p>Në shkollën fillore "Kongresi i Manastirit" është bërë renovimi i objektit .</p> <p>Rregullimi i nyjeve sanitare dhe ujit në QEAP "Agimi" dhe Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj"</p> <p>Në Gjinnazin "Skënderbeu" është bërë rregullimi i kulmit</p> <p>Në shkollën "Jusuf Gërvalla" në Biçec është ndërtuar objekti për vendosjen e kaldajave të ngrohjes, faza e parë.</p> <p>Në shkollën fillore "Agim Bajrami" është bërë rregullimi i nyjeve sanitare dhe është shtruar me linoleum një mësonjëtorë</p> <p>Janë lyer shkollat në Bob, Dubravë, Biçec, Doganaj, Begracë, Ivajë, Stagovë dhe Elezaj në bashkëpunim me GLZ-in gjerman.</p>
Rikualifikimi, organizimi dhe sistemimi i mësimit në mesimdhënësve.	<p>Mbi 50 mësimitdhënës me shkollë të lartë pedagogjike janë rikualifikuar në nivelin Baçelor, dhe është bërë harmonizimi i pagave të tyre .</p> <p>Është bërë organizim i brendshëm i mësimitdhënësve dhe sistemimi i tyre sipas përgatitjes profesionale .</p>
Shpallja konkurseve për vendet e lira të punës	<p>Është shpallur konkurs për Drejtor të Shkollave fillore të mesme të ulëta, dhe për mësimitdhënësit që nuk kanë pasur përgatitje adekuate për vendet e tyre të punës, ku është bërë përzgjedhja e tyre sipas akteve</p>

	normative në fuqi .
--	---------------------

Prioriteti 7: Promovimi i trashëgimisë kulturore	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2013
Zbatimi i Planit Lokal të Trashëgimisë Kulturore-PLTK	Për here të parë është vendosur një plan i kësaj fushe për Komunën e Kaçanikut
Restaurimi i Odës së Berat Luzhës-Begracë	Përfundimi i restaurimit
Restaurimi i Kullës së Shaip Hysaj- Stagovë	Përfundimi i restaurimit
Restaurimi i Kullës së Rufki Brahës- Stagovë	Përfundimi i restaurimit

Prioriteti 8: Përmirësimi i aktivitetet rinore	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2014
Shënimi i datave të rëndësishme për rininë	Është bërë masivizimi dhe ngritja në nivel më të lartë i aktiviteteve rinore - sportive
Organizimi i aktiviteteve kulturore	Përmes organizimit të Festivalit XXVI me - radhë është arritur të ruhen vlerat kulturore Është ruajtur tradita e këngëve dhe valleve popullore që kultivohen në trojet shqiptare
Organizimi i aktiviteteve sportive	Identifikimi i talentëve për aktivitetet sportive Janë mbajtur turne në fusha të ndryshme sportive që kanë promovuar talent të rinj.

Prioriteti 9: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve

Aktivitete kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet /progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2014
Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga qytetarët Mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti Komunës	<p>Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen e kërkesave të tyre qytetarët janë informuar me kohë, gjithashtu kjo drejtori është angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve me mjete nga buxheti komunës, nga projektet e realizuara kanë përfituruar 465 fermerë:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Projekti për mbështetje të fermerëve me repromaterial bujqësor farë misri, dhe pleh mineral, me realizimin e këtij projekti kanë përfituruar 216 fermerë , vlera e projektit 13,376.40 € * Projekti për mbështetjen e bletarëve me koshere bletësh, me realizimin e këtij projekti kanë përfituruar 53 bletarë, vlera e projektit 11,620.00€ (Investimi i komunës 9,296.00 ose 80 % participi nga bletarët 2,324.00 € ose 20%) *Projekti për mbështetje të fermerëve me repromaterial bujqësor farë gruri, dhe pleh mineral, me realizimin e këtij projekti kanë përfituruar 184 fermerë , vlera e projektit 14,904.00 € <p>Projekti për panairin e gjedhit “Kaçaniku 2014 , ky projekt është realizuar me mjetet e bashkëfinancimit nga buxheti i komunës (1,800.00€), mbështetjes së OJQ-ës KS-Kosova 500 € dhe ProCredit Bank 150 €, (12 fermerë kanë përfituruar shpërblime në vlerë prej 100-250€), vlera projektit 2,450.00€,</p> <ul style="list-style-type: none"> * Këtë vit kemi realizuar edhe projektin për rregullimin e kanalit të ujitjes Nga fshati Doganaj deri në fillim të Lagjes Lekaj 1200 m gjatësi , vlera e projektit 29,951.23€. <p>Përmes realizimit të këtij projekti, fermerët tani kanë kushte më të mira për ujitjen e kulturave bujqësore, shfrytëzim më racional të ujit si dhe zvogëlim të punës së krahut lidhur me rregullimin dhe pastrimin e kanalit të ujitjes.</p> <p>Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në vlerë prej 10.159.50 €</p>
Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale	Fermerët kanë përfituruar njohuri teorike dhe praktike për kultivimin dhe ruajtjen e kulturave bujqësore nga sëmundjet dhe dëmtuesit
Trajtimi i qenve endacak	Zvogëlimi i rrezikut për nxënësit e shkollave nga kafshimi i qenve endacak, qentë endacak kanë paraqitur rrezik serioz, sidomos për fëmijët. Vlera e projektit 5.520 €

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

